

## Thirrje për Aplikime në Programin e Bursave për Studime Master në SHBA

Programi Master dhe Internship (MIP) është krijuar në vitin 2016 nga Fondacioni Shqiptaro–Amerikan për Zhvillim (AADF), për t’u ofruar profesionistëve të rinj dhe me potencial lidershipi, mundësi studimi në nivel Master në SHBA. AADF ka lidhur partneritet me American Councils for International Education e cila ndihmon gjatë fazës së përzgjedhjes së aplikantëve, identifikon universitetet në SHBA sipas programit të studimit përzgjedhur nga kandidatët, si edhe asiston të përzgjedhurit gjatë studimeve në SHBA duke monitoruar ecurinë e tyre akademik. Ky program bashkë-financohet nga Fondacioni Biberaj, themeluar në SHBA.

Programi MIP shpall thirrjen për aplikime në një nga fushat e mëposhtme:

- Administrim Biznesi dhe Menaxhim
- Bujqësi
- Kulturë
- Eko-Turizëm & Shërbime Pritëse
- Edukim
- Shëndet Publik
- Teknologji Informacioni & Shkenca Kompjuterike
- Administrim Publik
- Politika Publike

AADF mbulon të gjitha kostot e pjesëmarrjes në program si më poshtë:

- Kurse intensive parapërgatitore dhe testimit të TOEFL, GRE dhe GMAT
- Tarifat Vjetore të Studimit
- Akomodimin dhe Kostot e Jetesës
- Librat për Studim
- Sigurim Shëndetësor
- Udhëtimin në SHBA
- Tarifa SEVIS<sup>1</sup> & Kostot e Vizës

Ky program është i hapur për çdo kandidat që plotëson kushtet më poshtë:

- Zotëron pasaportë shqiptare të vlefshme përgjatë periudhës së pjesëmarrjes në program
- Rezident në Shqipëri gjatë kohës së aplikimit dhe procesit të përzgjedhjes
- Duhet të zotërojë diplomë universitare në fushat e studimit të programit, ose fusha të ngjashme, të paktën 4 vite studime ose sipas sistemit të Bolonjës (3 vite Bachelor + 1 vit Master, 3 vite Bachelor + 2 vite Master). Diploma e universitetit do të vlerësohet nga universitetet në SHBA gjatë procesit të përzgjedhjes
- Duhet të ketë mesatare të studimeve universitare mbi notën 8.0/3.5

---

<sup>1</sup>Student and Exchange Visitor Information System.

- Duhet të ketë të paktën dy vite përvojë pune në fushën e studimit dhe të tregojë aftësi drejtuese
- Duhet të ketë aftësi profesionale dhe potencial për të qenë drejtues në fushën e specializimit të përzgjedhur
- Zotërim i gjuhës Angleze. Çertifikata e gjuhës angleze TOEFL, GRE dhe GMAT<sup>2</sup> nuk kërkohet në këtë fazë të aplikimit
- Motivim në ndjekjen e programit të studimit, në përputhje me përvojat e mëparshme të punës dhe aktivitete ekstra-kurrikulare;
- Kandidatët do të kryejnë testin e GRE& GMAT<sup>3</sup> në varësi të kërkesave të programit të studimit
- Duhet të jetë i/e disponueshëm/me të fillojë studimet akademike në SHBA në verën e 2020
- Duhet të plotësojë kriteret për të përftuar vizën e programeve të shkëmbimit J-1<sup>4</sup>
- Duhet të pranojë kthimin në Shqipëri dhe të jetë resident minimumi 2 vite për të kontribuar në vend. Para fillimit të vitit akademik do të firmoset marrëveshja me AADF
- Të jetë proaktiv në rrjetin MIP Alumni, pas kthimit në Shqipëri
- Kandidatët të cilët zotërojnë diploma Master nga një institucion i arsimit të lartë në SHBA nuk kualifikohen për të aplikuar

Aplikimi duhet të përfshijë:

- Formularin e aplikimit
- Kopje të përkthyer dhe noterizuara të listës së notave dhe diplomave lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë
- Resume
- Letër nga punëdhënësi i/e cili/a konfirmon punësimin
- Një kopje të faqes së parë të pasaportës
- Kopje të çertifikatave të përvojave ekstra-kurrikulare, kualifikime, trajnime në lidhje me fushën e studimit

Thirrja për Aplikime për vitin akademik 2020 është e hapur deri më datë 5 Maj 2019, 11:59 PM (CET).

Për të mësuar më tepër rreth programit, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë më poshtë:

[https://www.mip-aadf.org/apply\\_master.html](https://www.mip-aadf.org/apply_master.html)

Formulari i aplikimit gjithashtu gjendet në faqen më poshtë:

<https://www.americancouncilsnetwork.org/mip/index.php>

Për çdo pyetje në lidhje me programin, kontaktoni në e-mail: [master@mip-aadf.org](mailto:master@mip-aadf.org)

---

<sup>2</sup>TOEFL (Test of English as a Foreign Language): TOEFL is an admissions requirement at U.S. institutions for applicants whose native language is not English. All non-native English-speaking candidates should immediately register for TOEFL.

<sup>3</sup>GRE (Graduate Records Examination): The GRE is required by U.S. graduate schools and/or departments for candidates in most fields other than Business Administration and Law. You should make every effort to register for the earliest possible administration of the GRE.

GMAT (Graduate Management Admissions Test): GMAT is an admissions requirement for applicants proposing to study Business or Management, as well as any fields which may fall within the scope of offerings of a Business school or department. Arrangements should be made immediately to take the GMAT.

<sup>4</sup> <https://j1visa.state.gov/programs>